



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.590/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevcu kryesues dhe Faton Ademi dhe Rustem Thaqi anëtarë, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Elviana Gacaferi me vendbanim në Gjermani, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me datën 17 tetor 2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 02.09.2021, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET i palejuar apeli Anr.590/2021, i paraqitur nga Elviana Gacaferi me vendbanim në Gjermani, me të cilin kërkon përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me datën 17 tetor 2021.

A r s y e t i m

Me datën 01.09.2021 PZAP-i, ka pranuar një apel nga Elviana Gacaferi me vendbanim në Gjermani, në të cilën pretendohet se ka aplikuar, për regjistrim si votues jashtë Kosove, mirëpo ankesa e saj ka të bëjë me ndërrimin e vendvotimit (vendbanimit) sepse në dokumentacionin e paraqitur për regjistrim si votues përmes postës ka dëshmuar se është banore e Komunës së Junikut, ndërsa në listë ka dal në komunën e Deçanit. Kërkon nga PZAP-i që të i mundësohet ndërrimi i vendvotimit nga Komuna e Deçanit në Junik.

Parashtruesi i apelit, ka bashkangjitur formularin e aplikimit si dhe kopjen e dokumentit identifikues/ letërnjoftimit.

Me datë 01.09.2021 PZAP ka parashtruar kërkesë për përgjigje në KQZ, me të cilën ka kërkuar që të njoftohet lidhur apelin e parashtruar nga pala ankuese, KQZ brenda afatit kohor është përgjigje në kërkesë në të cilën ka theksuar se Elviana Gacaferi, me numër të regjistrimi të KQZ-së 2021171021337, është votuese në listën e votuesve jashtë Kosovës. Emri i saj figuron në faqen numër 12 të Listës së Votuesve jashtë Kosovës, që është e publikuar në ueb faqen e KQZ-së.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoj të gjitha pretendimit e apelimit, në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se:

Parashtruesit të Apelit i mungon interesi juridik

Me datë 01.09.2021 Elviana Gacaferi në PZAP, ka parashtruar në apel ndaj KQZ-së, me të cilin kërkon ndërrimin e vendbanimit në listën e votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, që do të mbahen me datën 17 tetor 2021.

PZAP ankesën në këtë rast e trajton si apel, meqenëse ndaj vendimeve të KQZ-së, palët e interesuar mund të parashtrojnë apel.

Me rastin e shqyrtimit të apelit PZAP iu ka drejtuar KQZ-së, për të dhënë përgjigje në raport me apelin e parashtruesit dhe pretendimeve që dalin nga i njëjti. KQZ-ja, me anë të përgjigjes në apel dërguar në PZAP ka konfirmuar se parashtruesi i apelit gjendet në listën e votuesve meqenëse i njëjti i plotëson kushtet për tu përfshirë në listë, me numër të regjistrimi të KQZ-së 2021171021337, është votuese në listën e votuesve jashtë Kosovës, emri i të cilës figuron në faqen numër 12 të Listës së Votuesve jashtë Kosovës,

PZAP, duke vlerësuar apelin e personit në fjalë vlerëson se në rastin konkret të njëjtit i mungon interesi juridik për parashtrimin e apelit meqenëse e njëjta veç është i përfshirë në listën e votuesve.

Prandaj PZAP-i, mbi këtë baze dhe nga arsyet e sipërsënuar dhe në kuptim të dispozitës së nenit 115.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.590/2021 më datën 02.09.2021

Kryesuesi i Panelit
Adnan Konushevi

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa, sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.